



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 20.06.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.06.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Nente Vellezerit" për aktivitetin: "Rekonstruimi i rruges "Deshmoret e Gollakut dhe ne Hajvali" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-1897-521 nxjerr:

### VENDIM

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Nente Vellezerit" e datës 26.06.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rekonstruimi i rruges Deshmoret e Gollakut dhe ne Hajvali" dhe me Nr.616 19 1897 521, kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 17.06.2019*, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Vërtetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 17.06.2019;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetim

Operatori Ekonomik "Nente Vellezerit" me datë 19.06.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rekonstruimi i rruges Deshmoret e Gollakut dhe ne Hajvali" me Nr.616 19 1897 521  
Autoriteti Kontraktues, me datë 20.06.2018 dhe ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimi kryesor i ankuesit ka qenë se me rastin e caktimit të menaxherit të projektit ka bere gabim teknik dhe se është eliminuar pa të drejtë nga ky aktivitet. Ia perkujtojme pretenduesit se ne dosjen e tenderit kërkesa ka qene e qarte se menaxheri i projektit duhet te jete inxhinier i diplomuar i ndertimit dhe se pretenduesi se bashku me anetarin e grupit kane nenshkruar dhe vulosur nje Vendim-Marreveshje per caktimin e menaxherit me titullin bachelor i ndertimit Ky Vendim eshte dorezuar se bashku me tenderin dhe si i tille nuk mund te

ndryshohet. Poashtu nuk mund te behet fjale per gabim pasi qe eshte fjala per nje marrerveshje ne mes dy partnereve dhe e nenshkruar me rastin e themelimit te grupit. Zyrtari Përgjegjës i prokurimit duke u bazuar në konstatimet paraprake ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit